



Pranimi / Dorezimi Puneheni/Prodato Received/Delivered		20-01-2023	3	viti god year
Organ /Bjësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr. Prof Et. Prof Prof No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicima Quantity	
SKUMSHICK	615/2023		117	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1041/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1041/2022 të datës 22.11.2022 të parashtruar nga ankuesi Agron Maloku të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat Hajzer Salihu, me adresë: Rruga "Fehmi Agani", Hyrja 154, kati I, Nr. 8 në Prishtinë, kundër Vendimit nr. Nr.144/2022 të datës 10.11.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "transferim" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1041/2022 e datës 22.11.2022 e parashtruar nga ankuesi Agron Maloku.
- II. **Shfuqizohet** Vendimi me Nr.144/2022 i datës 10.11.2022 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa **detyrohet** Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të nxjerrë raport meritor lidhur me sistemimin e ankuesit në pajtim me legjislacionin në fuqi si dhe pikëpamjet juridike si në arsyetim të këtij vendimi.
- III. **Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Nëpunësi civil Agron Maloku më datë 22.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 7312/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.144/2022 të datës 10.11.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me pretendimet për shkelje procedurale dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli më datë 13.12.2022, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat bashkëngjitura të lëndës, ndërsa me datë 16.12.2022 ka pranuar edhe plotësimin e përgjigjes në ankesë me prova shtesë.

Me kërkesë të Kryetarit të Kolegjit, Kryetari i Këshillit, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin Nr.105 të datë 30.12.2022 ka vazhduar afatin e vendimmarrjen lidhur me këtë çështje ankimore edhe për dhjetë (10) dite pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 7312/2022 të datës 22.11.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 144/2022 të datës 10.11.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; E-mailin e datës 31.10.2022 dërguar nga ankuesi për Njësinë e Burimeve Njerëzore me korrespondencën e bashkëngjitur prej 6 faqesh; Shkresën e datës 30.09.2010; Shkresën e datës 01.08.2022 me numër reference: 10/2022 me numër prot:2955; Çertifikatën e datës 05.06.2009; Çertifikatën e datës 22.12.2009; Çertifikatën e datës 2306.2010; Çertifikatën e datës 11.02.2016; Çertifikatën e datës 01.12.2010; Çertifikatën e datës 16.02.2016; Çertifikatën e datës 08.02.2012; Çertifikatën e muajit dhjetor 2008; Diplomën e datës 10.11.2021 me numër:127/21; Diplomën e datës 08.02.2006 me numër:1385; Shkresën e titulluar "letër-pajtueshmëri për dhënien e nënshkrimit; Kërkesën e datës 20.04.2021 me referencë:AKK-02-03-948/21; Reagimin e datës 24.08.2022 me referencë:11/2022; Shkresën e titulluar "letër-pajtueshmëri për dhënien e nënshkrimit" e datës 31.05.2022; Kërkesën e datës 31.05.2022 me numër prot:1917; Shkresën e titulluar "letër-pajtueshmëri për dhënien e nënshkrimit" e datës 01.08.2022; Vendimin e datës 19.05.2017; Kërkesë e datës 28.07.2022; Shkresën e titulluar "letër-pajtueshmëri për dhënien e nënshkrimit" e datës 17.05.2022; Ankesën e datës 17.05.2022 me referencë:07/2022; Kërkesën për inspektim të datës 10.05.2022; E-mailin e datës 05.04.2022 dërguar nga A.H për B.G; Kërkesën e datës 11.03.2022; Kërkesën e datës 27.09.2022 dërguar për DMZP; Ë emërimin e ankuesit të datës 05.09.2012; Çertifikatën e datës 17.06.2022; Vendimin e datës 21.08.2019 i Ministrit të Punëve të Jashtme; Vendimin e datës 15.09.2022 me numër:138/2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Ë emërimin e datës 08.04.2021 me shifër AE.Nr.27/2021; Referencën e datës 10.08.2004; Vendimin e datës 05.01.2004; Kontratën e punës e datës 01.01.2004; Letër referencën e datës 10.12.2007; Kontratën e punës të datës 09.05.2007; Kontratën e punës të datës 01.08.2010; Kontratën e punës e datës 01.08.2008; Vendimin për emërim i datës 28.07.2008 me numër:97/08; Vendimin për dhënien eës nga

Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme i datës 30.04.2014; Vendimin e datës 13.07.2018; Vendimin e datës 04.03.2014 i Komisionin për Grada dhe Disiplinë; Vendimin me numër ref:35/2016 (data e palexueshme), Formulari i vlerësimeve të rezultateve në punë për vitin 2017; Formulari i vlerësimeve të rezultateve në punë për vitin 2016; Formulari i vlerësimeve të rezultateve në punë për vitin 2015; Formulari i vlerësimeve të rezultateve në punë për vitin 2015; Formulari i vlerësimeve të rezultateve në punë për vitin 2011; Formulari i vlerësimeve të rezultateve në punë për vitin 2020; E-mailin e datës 21.06.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në kërkesë e datës 16.12.2022; Vendimin e datës 01.02.2022 me nr.214/2022 i Kryeministrit të Republikës së Kosovës; E-mailin e datës 28.10.2022 lidhur me pozitën e mbetur të lira dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Njoftimin e datës 27.10.2022 dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Vendimin për miratimin e përshkrimit të detyrave të punës i datës 16.03.2022 i DMPZP-së; E-mailin e datës 12.10.2022 dërguar nga V.B për Këshillin në korrespondencën e bashkangjitur; Listën e sindikatave të regjistruara; Përgjigjen e datës 13.12.2022; Vendimin për transferim i datës 15.09.2022; Raporti i veçantë i punës së Komisionit të Ristrukturimit i datës 31.10.2022; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa në MPJD; Konkursin e datës 18.01.2022; Shkresën-Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Arkivës nder komunale në Prishtinë-Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës; Shkresën-Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Avancimin e të Drejtave të Njeriut; Shkresën-Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin Rajonal dhe Koordinimin e Nismave Rajonale në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal; Shkresën-Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Drejtorisë për Administratë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës; Shkresën-Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Akt emërimit e ankuesit të datës 08.04.2021 me numër AE.nr.27/2021; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme; E-mailin e datës 28.10.2022 dërguar nga ankuesi për Njësinë e Burimeve Njerëzore me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 faqesh; E-mailin e datës 31.10.2022 dërguar nga ankuesi për Njësinë e Burimeve Njerëzore me korrespondencën e bashkangjitur prej 4 faqesh; E-mailin e datës 27.10.2022 dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Shkresën-Shtojca I-Formula e vlerësimit, për pozitën-Drejtor i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme; E-mailin e datës 07.10.2022 dërguar nga B.B për V.B; E-mailin e datës 12.12.2022; E-mailin e datës 12.12.2022 dërguar nga F.B për V.B.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, **SEPSE**:

Nga vlerësimi i provave të lëndës rezulton së më Vendimin Nr.214/2022 të datës 01.02.2022 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës është miratuar Rregullorja Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e publikuar me datë 01.02.2022 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe si rrjedhojë si rezultat i bashkimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës ka pas shuarje të disa pozitave si dhe ndryshime në përshkrimin e vendeve të punës.

Me tej, nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së me Vendimin V.nr.1/KR/2022 të datës 24.02.2022 të Zëvendësueses së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë (tutje DMZP-ja) është themeluar Komisioni i Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

ndërsa Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në MPJD ka njoftuar individualisht ankuesin se në rastin konkret të ristrukturimit do të aplikohen dispozitat e nenit 54 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, ka gjetur se në bazë të Akt Emërimit me shifër AE.Nr.77/2020 të datës 08.04.2021 ka qenë i punësuar në pozitën Udhëheqës i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kurse sipas Vendimit Nr.Ref:274/2014 i datës 30.04.2014 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të njëjtit i është dhënë "Grada diplomatike-Këshilltar" në kuadër të Shërbimit të Jashtëm, ndërsa sipas Rregullores Nr. 01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematzimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kjo pozitë nuk është paraparë, respektivisht është ndarë si departament dhe janë krijuar dy njësi organizative apo dy (2) pozita, gjegjësisht pozitat Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa si dhe Drejtor i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme.

Meqenëse pozita që ka mbajtur ankuesi, ka pësuar ndryshime dhe sa i përket emërimit në pozitën Drejtor i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme, Komisioni i Ristrukturimit ankuesin e ka vlerësuar me gjithsejtë pesëdhjetë e tetë (58) pikë, ndërsa kandidatin tjetër R.Z me shtatëdhjetë e tetë (78) pikë, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 14 paragrafi 5 të Rregullores Nr.14/2020 Për-Transferimin e Nëpunësve Civilë ku përcaktohet se: "5. Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve civil për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kriterë: 5.1. vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil; 5.2. vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë; 5.3. kualifikimet profesionale të nëpunësve civilë. 5.4. trajnimet", gjegjësisht ankuesi nuk është rekomanduar për pozitën e lartcekur ngase kandidati tjetër ka fituar më shumë pikë mbi bazën e kriterëve të përcaktuara si më lartë, ndërsa për shkak të kualifikimeve të posaçme respektivisht njohjes së gjuhës së huaj, Komisioni i Ristrukturimit nuk ka mund të rekomandojë për emërim ankuesin në një pozitë të kategorisë së njëjtë brenda ministrisë për arsye se i njëjti nuk ka plotësuar kushtet e posaçme për pozitat e lira përkatëse, ndërsa i ka rekomanduar Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë transferimin në një pozitë të kategorisë së njëjtë në një institucion tjetër të shërbimit civil, kurse Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë e ka transferuar ankuesin në pozitën Drejtor i Departamentit të Financave dhe Shërbime të Përgjithshme në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.

Ankuesi më datë 25.07.2022 kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022 ka kthyer çështjen në rishqyrtim të Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj çështjen e ankuesit, ndërsa Komisioni i Ristrukturimit me rastin e rishqyrtimit të lëndës së ankuesit sipas Vendimit të Këshillit A.nr.723/2022, ka nxjerrë Raportin e veçantë të punës me numër protokoll: 1620 të datës 01.11.2022, duke i propozuar përsëri për të njëjtat arsye Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publike që ankuesi të transferohet në pozitën Drejtor i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë, ndërsa përmes Vendimit me Nr.144/2022 të datës 10.11.2022 Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë e ka transferuar ankuesin në pozitën Drejtor i Departamentit të Financave dhe Shërbime të Përgjithshme në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë



Protected with free version of Watermarkly. Full version doesn't put this mark.

Kolegji i Këshillit, fillimisht ka shqyrtuar pozitat e kategorisë së mesme drejtuese që janë të lira në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës të cilat janë: *Drejtor i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate; Drejtor i Departamentit për Diplomaci Publike, Drejtor i Departamentit për NATO dhe Politika të Sigurisë, Drejtor i Departamentit për Organizata Ndërkombëtare dhe Drejtor i Departamentit të Protokollit të Shtetit*, dhe ka konstatuar që për pozitën *Drejtor i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate* tek kualifikimet e posaçme formale kërkohet: *“Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja duhet të dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze”*, për pozitën *Drejtor i Departamentit për Diplomaci Publike* tek kualifikimet e posaçme formale kërkohet: *“Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja duhet të dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze”*, për pozitën *Drejtor i Departamentit për NATO dhe Politika të Sigurisë* tek kualifikimet e posaçme formale kërkohet: *“Njohje e gjuhës angleze ose gjuhën frënge e në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja duhet të dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose gjuhën frënge, ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze ose gjuhën frënge”*, për pozitën *Drejtor i Departamentit për Organizatat Ndërkombëtare* tek kualifikimet e posaçme formale kërkohet: *“Njohje e ndonjë prej (6) gjuhëve zyrtare të OKB-së, në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e këtyre gjuhëve duhet të dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhët e lartcekura angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhët e lartcekura”*, dhe për pozitën *Drejtor i Departamentit të Protokollit të Shtetit*, tek kualifikimet e posaçme formale kërkohet: *“Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e këtyre gjuhëve duhet të dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhët e lartcekura angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhët e lartcekura”*. Kolegji nga këto rrethana, konstaton se ankuesi nuk ka plotësuar kushtet e posaçme formale për këto pozita duke mos ofruar dëshmi relevante për këtë, kështu që ankuesi nuk mund të argumentoj me asnjë provë që ndryshimi i kualifikimeve të posaçme është bërë me qëllim të dëmtimit të tij, sepse ky përshkrim është i miratuar.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publik nënin 4 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *“1. Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë. 2. Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtese për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve”*, si dhe nënin 26 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.4 i Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *“1. Përfaqësuesit diplomatikë dhe konsujt, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në misionet diplomatike, marrin grada diplomatike ose konsullore. 2. Gradat diplomatike në shërbimin e jashtëm janë: 2.4. këshilltar”*, si dhe nënin 11 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm Diplomantik e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr.04/2014 për Shërbimin e Jashtëm Diplomantik ku përcaktohet se: *“Data efektive e*

emërimit të anëtarit me karrierë në shërbim të jashtëm, llogaritet duke filluar nga dita e par kur ai/ajo ka filluar punën në Ministri”, rrjedh se ankuesi Agron Maloku i cili ka “Gradën Diplomatiqe-Këshilltar e ka statusin e veçantë të nëpunësit civil të përcaktuar me nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, andaj në rastin konkret transferimi i ankuesit jashtë institucionit ku e ka të themeluar marrëdhënien e punës e që lidhet ngushtë me statusin e nëpunësit të jashtëm, sikurse edhe me zhvillimin e karrierës dhe gradave diplomatike, duhet të merren parasysh edhe dispozitat e ligjit të veçantë për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës si dhe akteve tjera nënligjore që rrjedhin prej tij.

Nga se u tha më lartë, Komisioni i Ristrukturimit me rastin e rishqyrtimit të lëndës së ankuesit sipas vendimit të Këshillit A.nr.723/2022 dhe nxjerrjes së Raportit të veçantë të punës me numër protokolli: 1620 të datës 01.11.2022, përmes të cilit raport i është propozuar përsëri Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publike që ankuesi të transferohet në pozitën Drejtor i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit të veçantë ngase me rastin e transferimit të ankuesit jashtë institucionit në kuadër të cilit ka të themeluar marrëdhënien e punës, të njëjtit i ka humbur edhe statusi i nëpunësit në shërbimin e jashtëm, gjegjësisht ankuesit në rastin konkret i është cenuar e drejta që buron nga neni 31 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 i të njëjti ligj ku përcaktohet se: *“Nëpunësi i shërbimit të jashtëm ka të drejtë: 1.3. të mbajë funksione në Ministrinë e Punëve të Jashtme ose në misionet diplomatike, në përputhje me nivelin profesional dhe gradën që gëzon”* andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit njëzëri konstaton se Raportit me numër protokolli 1620 i datës 01.11.2022 i Komisionit të Ristrukturimit sikurse edhe Vendim me Nr.144/2022 i datës 10.11.2022 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik i datës janë akte administrative të paligjshme.

Prandaj, mbi bazën e analizimit të dispozitave të ligjit material dhe ligjit për shërbimin e jashtëm dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit çështjen e transferimit të ankuesit e kthen tek Komisioni i Ristrukturimit duke e detyruar të njëjtin që fillimisht ankuesit t’i ofrohet mundësia me pëlqimin e tij paraprak të transferohet në cilëndo pozitë të lirë (fillimisht duke filluar nga pozita e cila është e njëjtë apo më e përafërt me pozitën që ka mbajtur ankuesi) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për të cilat pozita të njëjti i plotëson kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, qoftë edhe pozitë më e ulët sesa pozita të cilën e ka ushtruar sipas aktit të emërimit me qëllim të dhënies së mundësisë të ruajtjes së statusit të nëpunësit të shërbimit të jashtëm, ndërsa në rast se ankuesi mbetet pranë insistimit dhe pretendimit të tij që të transferohet vetëm në pozitë ekuivalente brenda Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës pavarësisht që mund të mos i plotësoje kriteret e caktuara, si rrjedhojë në këtë rast plotësohet kushti i dhënë sipas këtij vendimi që Komisioni i Ristrukturimit t’i propozojë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik që ankuesi të transferohet në një pozitë ekuivalentet në ndonjë institucion tjetër në kuadër të Shërbimit Civil të Kosovës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetar i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1041/2022

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat Hajzer Salihu;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së